



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06

**Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

**Vendos:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 28 maj 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Kërkesën Shtesë të Thaçit për Zgjatje Afati**

---

**Prokurorit të Specializuar**  
Xhek Smith

**Mbrojtësit të Hashim Thaçit**  
Gregori Kihou

**Mbrojtësit të Viktimave**  
Sajmon Loz

**Mbrojtësit të Kadri Veselit**  
Ben Emerson

**Mbrojtësit të Rexhep Selimit**  
Dejvid Jang

**Mbrojtëses së Jakup Krasniqit**  
Venkatesvari Alagenda

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në pajtim me nenet 39(1) dhe (13) dhe 41(10) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 9(5)(a) dhe (6) dhe 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), merr këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 24 shkurt 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e ndryshoi afatin brenda të cilit Hashim Thaçi (“z. Thaçi”) duhej të dorëzonte parashtrime mbi vijimin e ekzistencës së arsyeve për mbajtjen e mëtejshme në paraburgim deri në dhjetë ditë pas marrjes së njoftimit për vendimin e panelit të Gjykatës së Apelit mbi apelin e z. Thaçi kundër vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake me të cilin rrëzohej kërkesa e tij për lirim të përkohshëm.<sup>2</sup>

2. Më 30 prill 2021, paneli i Gjykatës së Apelit e rrëzoi apelin e z. Thaçi.<sup>3</sup>

3. Më 12 maj 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e ndryshoi më tej afatin e lartpërmendur në lidhje me z. Thaçi deri më 31 maj 2021.<sup>4</sup>

4. Më 19 maj 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e ndryshoi të njëjtin afat në lidhje me të akuzuarit e tjerë deri më 31 maj 2021.<sup>5</sup>

5. Më 27 maj 2021, z. Thaçi dorëzoi kërkesë për ndryshim të mëtejshëm të afatit të lartpërmendur deri më 30 qershor 2021, për të siguruar që mbrojtësi i tij i sapoemëruar të ketë kohën e mjaftueshme për të bërë këto parashtrime dhe për dhënë informacione

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-06, F00206, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit*, 24 shkurt 2021, publik, para. 6.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-06/IA004, F00005/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Version Publik i Redaktuar i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm*, 30 prill 2021, publik, para. 91.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-06, F00292, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Thaçit për Zgjatje të Afatit*, 12 maj 2021, publik, para. 7.

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-06, Transkript, 19 maj 2021, publik, f. 451, rreshti 19 – f. 452, rreshti 2.

të tjera shtesë në mbështetje të këtyre parashtrimeve ("Kërkesa").<sup>6</sup> Z. Thaçi heq dorë edhe nga e drejta për rishikim të paraburgimit brenda afatit dymujor të parashikuar në nenin 41(10) të Ligjit dhe në rregullën 57(2) të Rregullores.<sup>7</sup>

## II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Në pajtim me rregullën 9(5)(a) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të shkurtojë *proprio motu* afatet e përcaktuara prej Rregullores apo prej panelit.

7. Në pajtim me rregullën 9(6) të Rregullores, kur nuk i shkaktohet padrejtësi palës kundërshtuese, lejohet që vendimi në lidhje me një mocion për ndryshimin e afateve të merret duke mos i dhënë palës kundërshtuese mundësinë e shprehjes së mendimit.

8. Neni 41(10) i Ligjit dhe rregulla 57(2) e Rregullores parashikojnë se, pas kalimit të dy (2) muajve nga vendimi i fundit për paraburgim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose paneli i ngarkuar me çështjen shqyrton nëse ekzistojnë ende arsyet për paraburgim dhe nxjerr vendim për lirim apo përfundimin e paraburgimit.

## III. DISKUTIM

9. Pasi shqyrtoi arsyet e paraqitura prej z. Thaçi, veçanërisht që mbrojtësi i tij vijon të jetë në proces të marrjes së informacioneve të tjera shtesë në mbështetje të këtyre parashtrimeve dhe që z. Thaçi ka hequr dorë nga e drejta e rishikimit të paraburgimit përpara përfundimit të afatit dymujor të parashikuar në nenin 41(10) të Ligjit dhe në rregullën 57(2) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se janë dëshmuar arsye bindëse që justifikojnë ndryshimin e kërkuar të afatit.

---

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-06, F00325, Mbrojtja e z. Thaçi, *Kërkesë Shtesë për Zgjatje të Afatit në lidhje me Parashtrimet për Mbajtjen e Mëtejshme në Paraburgim të z. Thaçi*, 27 maj 2021 (njoftuar më 28 maj 2021), konfidenciale, para. 7-9.

<sup>7</sup> Kërkesa, para. 10.

10. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton gjithashtu se të akuzuarit e tjerë mund të paraqesin parashtrimet e tyre për mbajtjen e mëtejshme në paraburgim brenda datës 31 maj 2021 ose mund të kërkojnë ndryshim të afatit brenda të njëjtës datë nëse edhe ata janë në proces të marrjes së informacioneve të tjera shtesë në mbështetje të parashtrimeve të tyre dhe nëse heqin dorë nga e drejta për rishikim të paraburgimit përpara përfundimit të afatit dymujor të lartpërmendur.

## IV. VENDIM

11. Për arsye të lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **MIRTON** Kërkesën;
- b. **URDHËRON** z. Thaçi të paraqesë parashtrime mbi faktin nëse ekzistojnë ende arsye për mbajtjen e tij në paraburgim brenda ditës **së mërkurë, 30 qershor 2021**, ndërsa përgjigjet dhe kundërpërgjigjet duhet të ndjekin afatet e parashikuara në rregullën 76 të Rregullores; dhe
- c. **URDHËRON** të akuzuarit e tjerë që, ose të paraqesin parashtrime në lidhje me mbajtjen e tyre në paraburgim brenda ditës **së hënë, 31 maj 2021**, kur përgjigjet dhe kundërpërgjigjet duhet të ndjekin afatet e parashikuara në rregullën 76 të Rregullores, ose të kërkojnë ndryshim të afatit brenda të njëjtës datë nëse ata janë në proces të marrjes së informacioneve të tjera shtesë në mbështetje të parashtrimeve të tyre dhe nëse heqin dorë nga e drejta për rishikim të paraburgimit përpara përfundimit të afatit dymujor të parashikuar në nenin 41(10) të Ligjit dhe në rregullën 57(2) të Rregullores.

/nënshkrimi/

**Gjykatës Nikola Giju**  
**Gjykatës i Procedurës Paraprake**

E premtë, më 28 maj 2021

Hagë, Holandë